

Shtojca 13

AGJENCIA E SHËRBIMEVE FUNERALE FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

Nr.prot.197/13

Data 30/04/2019

Për: Operatorin ekonomik “ SHPRESA-AL”sh.p.k.

Adresa: Rr.Urani Pano,pas Qendrës VEVE, Pll. 11-Katësh,Tiranë, [Tel:04 2271491](tel:042271491) e-mail:
shpresa.al@gmail.com

Procedura e prokurimit: Kërkesë për propozim

Numri i referencës së procedurës/lotit: REF-14504-03-20-2019

Përshkrim i shkurtër i kontratës: Blerje materiale ndertimi,si: rere, çimento, çakull, granil, hekur etj per nevoja te agjencise. Afati fillon nga data e nënshkrimit të kontratës dhe përfundon më datë 31.12.2019.

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [25.03.2019] [Nr.12]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët X; oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. O.E “SHPRESA-AL”sh.p.k

K31321021N

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera 2 698 000 (dy milion e gjashtëqind e nentëdhjete e tete mijë) leke pa TVSH.

(me numra dhe fjalë)

2. O.E “SARK” sh.p.k

K52531415H

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera 2 926 600(dy milion e nentëqind e njetzet e gjashte mijë e gjashtëqind) leke pa TVSH.

(me numra dhe fjalë)

3. O.E “EURO-ALB”sh.p.k

K66613407H

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera 2 909 600 (dy milion e nentëqind e nente mijë e gjashtëqind) leke pa TVSH.

(me numra dhe fjalë)

4. O.E “SIRETA 2F”sh.p.k

K51501008J

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera 2 999 999 (dy milion e nentëqind e nentëdhjete e nente mijë e nentëqind e nentëdhjete e nente) leke pa TVSH.

(me numra dhe fjalë)

5. O.E “2Z KONSTRUKSION”sh.p.k J63229466K
Emri i plotë i shoqërisë numri i NIPT-it

Vlera 2 980 000 (dy milion e nenteqind e tetedhjetë mijë) leke pa TVSH.

(me numra dhe fjalë)

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. O.E “SARK” sh.p.k K52531415H
Emri i plotë i shoqërisë numri i NIPT-it

2. O.E “2Z KONSTRUKSION”sh.p.k J63229466K
Emri i plotë i shoqërisë numri i NIPT-it

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

1. O.E “SARK” sh.p.k K52531415H

Nga shqyrtimi i dokumentacionit administrativ ligjor të operatorit ekonomik “SARK” sh.p.k në sistemin e APP rezultojnë se:

- Ka plotësuar të gjitha kriteret e përgjithshme të kualifikimit të kërkuara.
- Ka plotësuar të gjitha kriteret e veçanta të kapacitetit ekonomik dhe financiar.
- Në kriteret e veçanta të kapacitetit teknik ka keto mangësi:

a) Autoriteti kontraktor në pikën 2 të kapacitetit teknik në DST ka kërkuar: “*Operatori ekonomik duhet të vërtetojë se disponon 2 mjete kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës deri në 10 ton për transportimin e mallrave. Mjetet të jenë në pronësi ose me qera shoqëruar me dokumentet: 2.1 Për mjetet në pronësi duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit a) leje qarkullimi, b) çertifikatën e kontrollit teknik (i vlefshëm), c) siguracionin e mjetit (i vlefshëm) dhe d) licencën dhe certifikatën transport mallrash nga pushteti vendor (e vlefshme). Të gjitha mjetet të shoqërohen me fotografi të tyre, ku të dallohet qarte targa dhe marka. 2.2 Për mjetet e siguruar me qera, dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit a) leje qarkullimi, b) çertifikatën e kontrollit teknik (i vlefshëm), c) siguracionin e mjetit (i vlefshëm) dhe d) licencën dhe certifikatën transport mallrash nga pushteti vendor (e vlefshme), si dhe duhet të shoqërohet me kontratën noteriale të qerasë, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objektit të këtij prokurimi. Të gjitha mjetet të shoqërohen me fotografi të tyre, ku të dallohet qarte targa dhe marka.”, kriter i kërkuar për të mundësuar transportin e mallrave sipas nevojave të autoritetit kontraktor.*

Operatori ekonomik “SARK” sh.p.k nuk plotëson kriterin për dy kamion, pasi nga dokumentet e paraqitura rezultojnë se njëri prej kamioneve me targë AA455GJ ka mangësi në dokumentet e kërkuara, përkatësisht si më poshtë:

- Nga dokumentet e paraqitura mungon kontrata qeraje për mjetin me targë AA455GJ. Sipas Certifikatës së pronësisë së mjetit, datë 28.12.2016 rezultojnë se mjeti është në pronësi të subjektit B.B.F me NIPT K21514004Q. Ky fakt përvetësohet edhe në dokumentet e tjera të mjetit Leje qarkullimi nr.TRDA 6991916, Police sigurimi i mjetit datë 2.11.2018. Për mjetet me qera është kërkuar që mjeti të shoqërohet me kontratën noteriale të qerasë, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës së objektit

te këtij prokurimi.

- Mungon licenca dhe certifikata per transport mallrash nga pushteti vendor (e vlefshme) per mjetin me targe AA455GJ.

b) Autoriteti kontraktor ne piken 3 te kapacitetit teknik ne DST ka kerkuar: “*Çertifikaten ISO 9001-2015 per Sistemin e Menaxhimit te Cilesise te akredituar nga institucione shteterore vendase ose te huaja, objekti i se ciles te jete ne perputhje me objektin e prokurimit (e vlefshme)*”.

Operatori ekonomik ”SARK” sh.p.k ka paraqitur certifikaten ISO 9001-2015 me numer AQS/Q/22642017, e cila nuk eshte ne perputhje me objektin e prokurimit, per tregtim te materialeve te ndertimit.

- Ka plotesuar te gjitha kriteret te tjera.

Ne zbatim te nenit 53 pika 3 te ligjit nr.9643 date 20.11.2006, “Per Prokurim Publik” (te ndryshuar) “*Autoriteti kontraktor, ne zbatim te pikes 4 te ketij neni, vlereson nje oferte te vlefshme, vetem nese ajo eshte ne perputhje me te gjitha kerkesat dhe specifikimet e percaktuara ne njoftimin e kontrates dhe ne dokumentet e tenderit.....*”, per sa me siper oferta e paraqitur nga operatori ekonomik “SARK” sh.p.k shpallet e pavlefshme, pasi nuk ploteson te gjitha kriteret dhe specifikimet e kerkuara nga autoriteti kontraktor Agjencia e Sherbimeve Funerale ne dokumentet e tenderit.

2. O.E “2Z KONSTRUKSION”sh.p.k

J63229466K

Nga shqyrtimi i dokumentacionit administrativ ligjor te operatorit ekonomik “2Z KONSTRUKSION” sh.p.k ne sistemin e APP rezulton se:

- Ka plotesuar te gjitha kriteret e pergjithshme te kualifikimit te kerkuara.
- Ne kriteret e veçanta te kapacitetit ekonomik dhe financiar operatori ekonomik ka mangesi si me poshte”

Ne zbatim te nenit 27 pika 5 /c te VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik” (te ndryshuar), autoriteti kontraktor ne piken 3 te kapacitetit ekonomik dhe financiar ne DST ka kerkuar “***Një vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri. Mosshlyerja e detyrimeve të energjisë elektrike përbën shkak për skualifikimin e operatorit ekonomik, përveç rastit kur rezulton se detyrimet e papaguara të energjisë elektrike, të konfirmuara në vërtetimin e lëshuar nga furnizuesi, janë në proces ankimi në gjykatë. Furnizuesi i energjisë elektrike është i detyruar që ta lëshojë këtë vërtetim jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e depozitimit të kërkesës nga operatori ekonomik.***”, parashikimi ligjor kerkon shlyerjen e te gjitha detyrimeve te maturuara te energjise elektrike nga operatoret ekonomik pjesmarres ne procedura prokurimi.

Operatori ekonomik 2Z KONSTRUKSION sh.p.k ka paraqitur vertetimin me nr.prot.467, date 02.03.2019, ku rezulton se “***.....subjekti ka ne total 0 leke detyrime per faturat e energjise elektrike, vlere e llogaritur deri ne daten 02.03.2019, pa perfshire faturen koherente te muajit shkurt 2019***”.

Fatura e muajit Shkurt 2019 eshte maturuar ne muajin Mars dhe detyrimi i maturuar duhet te

paguhet brenda dates 31.03.2019, sipas parashikimit te vete fatures se OSHEE.

Operatori ekonomik 2Z KONSTRUKSION sh.p.k nuk ka paraqitur ndonje dokument qe verteton se detyrimet e maturuara per muajin Shkurt 2019 te jene paguar prej tij.

Per sa u arsyetua me siper, mosshlyerja e te gjitha detyrimeve te maturuara te energjisë elektrike përbën shkak për skualifikimin e operatorit ekonomik.

- Ka plotesuar te gjitha kriteret e veçanta te kapacitetit teknik.
- Ka plotesuar te gjitha kriteret te tjera.

Ne zbatim te nenit 53 pika 3 te ligjit nr.9643 date 20.11.2006, "Per Prokurim Publik" (te ndryshuar) "*Autoriteti kontraktor, ne zbatim te pikes 4 te ketij neni, vlereson nje oferte te vlefshme, vetem nese ajo eshte ne perputhje me te gjitha kerkesat dhe specifikimet e percaktuara ne njoftimin e kontrates dhe ne dokumentet e tenderit.....*", per sa me siper oferta e paraqitur nga operatori ekonomik "2Z KONSTRUKSION" sh.p.k shpallet e pavlefshme, pasi nuk ploteson te gjitha kriteret dhe specifikimet e kerkuara nga autoriteti kontraktor Agjencia e Sherbimeve Funerale ne dokumentet e tenderit.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë operatorin ekonomik "**SHPRESA-AL**" sh.p.k. me Adrese: Rr.Urani Pano,pas Qendrës VEVE, Pll. 11-Katësh,Tiranë, [Tel:04 2271491](tel:042271491) e-mail: shpresa.al@gmail.com se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej **[2 698 000 (dy milion e gjashtëqind e nentëdhjetë e tete mije) leke pa TVSH]/pikët totale të marra [_____] është identifikuar si oferta e suksesshme.**

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë *Agjencise se Sherbimeve Funerale me adrese: Rr. "Durrësit", nr.132, Tirane* sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 7 (shtate) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej *[vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra]*, siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 04/04/2019

Ankesa: Ka patur anekese nga operatori ekonomik "SARK" sh.p.k me shkresen date 06.04.2019, protokolluar nga agjencia jone me nr.prot.295, date 10.04.2019.

Ka marrë përgjigje: Autoriteti kontraktor Agjencia e Sherbimeve Funerale i ka kthyer pergjigje ankeses se operatorit ekonomik "SARK"sh.p.k me shkresen nr.prot.295/3, date 15.04.2019 me lende "Njoftim vendimi nr.prot.295/2, date 15.04.2019."

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

RAIMONDA SHINO

